
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

R A P O R T

I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2015

I. Gjendja e sigurisë

Sa i përket gjendjes së përgjithshme të sigurisë gjatë vitit 2015, ajo ka qenë e mirë dhe stabile. Bazuar në raportimet e përfaqësuesve të komuniteteve, nuk është regjistruar asnjë ekces ndëretnik në territorin e komunës së Prishtinës.

II. Qasja e komuniteteve jo shumicë në shërbimet publike

Komunitetet jo shumicë kanë pasur qasje të mira në shërbimet publike në të gjitha institucionet komunale. Komiteti për Komunitete, drejtoritë komunale me shërbimet e tyre, iu kanë kushtuar mjaft kujdes pjesëtarëve të komuniteteve, atyre që kanë kërkuar të pajisen me dokumentacion personal, familjar dhe pronësor.

III. Veprimtaria e Komitetit për Komunitete

Gjatë vitit 2015, Komitetit për Komunitete ka mbajtur 12 takime, në të cilat janë shqyrtuar këto çështje:

- Hartimi i Planit të punës së Komitetit për vitin 2016;
- Bashkëpunimi me drejtoritë dhe institucionet e tjera të Komunës: Kryetarin, zëvendëskryetarin, drejtorin e Administratës, zyrtarët e OSCE-së, Zyrën Komunale të Kthimit, MKK-në, Policinë e Kosovës, KFOR-in dhe zyrtarë të organizatave të tjera ndërkombëtare;
- Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të pjesëtarëve të komuniteteve mbi gjendjen e tyre ekonomike-sociale, të sigurisë, dhe objektivat e përbashkëta të kthimit;
- Shqyrtimi i propozimbuxhetit të Komunës për vitin 2016;
- Vlerësimi i vizitave të kryera në rajonet me pjesëtarë të komuniteteve, institucioneve komunale - shkollave në mjediset ndëretnike, organizatave shoqërore dhe aktiviteteve të tjera në bazë të Planit të punës të Komitetit për Komunitete në vitin 2015;
- Planifikimi i vizitave me zyrtarë të Divizionit për komunitete në MKK, dhe në Zyrën e komuniteteve pranë kryeministrit, për mundësi realizimi me mjete financiare të disa kërkesave të familjeve të komuniteteve, si: djegia e shtëpive dhe riparimet e shtëpive të cilat janë para rrënimit;

- Komiteti gjatë seancave ka nxjerrë shumë konkluzione, të cilat ua ka drejtuar drejtorive përkatëse për t'i zbatuar;
- Ka shqyrtuar, vlerësuar dhe dërguar për zbatim projekte të ndryshme për zhvillimin e komuniteteve jo shumicë të përgatitura nga ZKKK.

IV. Takimet e zyrtarëve të Zyrës për Komunitete

- Takime me pjesëtarët e KFOR-it, të cilat kishin për qëllim realizimin e bashkëpunimit korrekt dhe njoftimin e ndërsjellë përkitazi me projektet e vitit 2015, vazhdimin e bashkëpunimit, si dhe adresimeve të përbashkëta gjatë këtij viti. Zyra ka kontaktuar Ministrinë e Arsimit lidhur me mos zbatimin e pagesës së përfituar për bursë për dy nxënës të komunitetit ashkali;
- Takimi me përfaqësuesin e komunitetit ashkali, z. Idriz Berisha, rreth mundësisë për realizimin e projekteve të vitit 2015, si komunitet jo shumicë;
- Zyrtarët e ZKK-së kanë vizituar disa herë Qendrën për Paqe dhe Tolerancë, me qëllim të informimit të drejtpërdrejtë për problemet eventuale dhe të informimit të komunitetit serb; gjendja e tyre shëndetësore dhe vizitat mjekësore;
- Takimi me zyrtarë të OSBE-së, lidhur me çështjet e riintegritimit dhe çështje të tjera në kuadrin e respektimit të të drejtave të komuniteteve jo shumicë;
- Takimi me përfaqësuesin e komunitetit rom, z. Adnan Ajeti, për t'i diskutuar projektet që mund të procedohen, si dhe data të tjera të rëndësishme për komunitetin rom;
- Takime me drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, me qëllim të koordinimit të punëve dhe aktiviteteve që ndërlidhen me komunitetet jo shumicë; si dhe projektet të cilat i kanë dërguar pjesëtarët e komuniteteve në këtë drejtori, lidhur me projektet subvencionuse dhe koordinimi i punëve dhe aktiviteteve që ndërlidhen me komunitetet jo shumicë;
- Përgatitja e fushatës mbi regjistrimin civil falas të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas e planifikuar në periudhën 01. 02. – 15. 03. 2015;
- Takimi i Komitetit me kryetarin e Komunës, z. Shpend Ahmeti, më 28.08.2015;
- Përgatitja e takimit me organizatën "Monitor";
- Takimi me z. Valon Krasniqi, zyrtar i Departamentit për Shtetësi, Migrim dhe Azil në kuadër të MPB-së;
- Organizimi i takimeve me drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si dhe udhëheqësin e Sektorit të mirëqenies sociale. Në pika të përgjithshme u diskutuan mundësitë materiale për përfitim të ndihmave për komunitetet;
- Takime me disa organizata, si "Integra", "Help", "Unicef", ku u bisedua për riintegrimin e personave të riatdhesuar, mundësia e përfitimit të projekteve për Komunitete, me qëllim fuqizimi të Sektorit të biznesit, si dhe riintegrimi i familjeve të riatdhesuara RAE, të cilat marrin asistencë sociale, me pretekst të veçantë të fëmijëve të komuniteteve;
- Takime me zyrtarët e VO RAE lidhur me riintegrimin e familjeve RAE të riatdhesuara dhe familjeve të zhvendosura tani të kthyer, si familja e Asllan

Berishës, pjesëtar i komunitetit ashkali, e kthyer nga Maqedonia;

- Organizimi i 4 takimeve të Nëngrupit komunal të kthimit për shqyrtimin e 5 kërkesave për kthim të të zhvendosurve;
- Ndhimat emergjente, drutë për djegie, ndihmat sociale dhe ndihmat tjera, si dhe konstituimi i Grupit punues për hartimin e planit lokal të veprimit për ri integrimin e personave të riatdhesuar;
- Takim me znj. Kimete Shok, nga organizata joqeveritare “Omladinski Savez Gore”, me qëllim këshillimi lidhur me projektin dhe kriteret që duhet përmbushur në projektin për *ëmbëltor*;
- Takimi me znj. Valmira Krasniqi nga UNICEF-i;
- Takime me drejtorin e Administratës, z. Muhedin Nushi, lidhur me projektet e mundshme për procedim për komunitetet jo shumicë;
- Takim me drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës për zbatimin e projektit për nder të 8 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Romëve;
- Tryeza e rrumbullakët e organizuar nga VORAE për zbatimin e projektit trevjeçar – Përfshirja sociale dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për romët, ashkalitë dhe egjiptianët, si dhe integrimi i komuniteteve në shoqërinë kosovare;
- Takime pune në Qendrën për Punë Sociale;
- Vizita në kishën “Sveti Nikolla” në Prishtinë;
- Takim me z. Besim Zogaj nga Zyra rajonale e punësimit, si dhe vizita e takime të tjera.

V. Vizitat e Komitetit për Komunitete

Gjatë vitit 2015, Komiteti për Komunitete ka vizituar:

- Komunitetin ashkali, në lagjen “Kodrën e Trimave”;
- Shkollën fillore shumëtnike “Asm Vokshi” në Prishtinë;
- Shkollën fillore shumëtnike “Emin Duraku” në Prishtinë dhe
- Nxënësit e komunitetit turk, rom dhe boshnjak në Prishtinë.
- Me kërkesë të Komitetit për Komunitete, *Zyra për Komunitete ka vizituar shtëpinë e djegur të Miliqeviq Gordana në Bërnice të Poshtme, shtëpinë e djegur të Remzi Marollit, pjesëtar i komunitetit ashkali, në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë, dhe familjen e Faik Marollit, komuniteti ashkali, për djegien e shtëpisë.*

Zyra për kthim dhe riintegrim ka vizituar katër familje serbe të zhvendosura, te cilat kanë kërkuar kthimin e tyre në Bërnice të Poshtme, Bërnice të Epërme dhe në qytetin e Prishtinës.

VI. Kërkesat

Gjatë vitit 2015, Komiteti për Komunitete ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e pjesëtarëve të komuniteteve për furnizim me dru për ngrohje, ndihmë emergjente dhe për kompensim dëmi. Këto kërkesa janë proceduar nga drejtoritë përkatëse për realizimin e tyre. Komiteti ka shqyrtuar edhe 6 kërkesa të familjeve të komunitetit serb për riparim të shtëpive dhe ka kërkuar nga ZKKK-ja që zyrtarisht të kërkojnë nga Drejtoria e Urbanizmit që të emërojë një komision,

të përberë nga inxhinierë të ndërtimit, për vlerësimin profesional për shtëpitë e këtyre familjeve, të cilat duhen të kualifikohen në mënyrë profesionale për riparim apo ndërtim.

VII. Ndihma familjeve dhe nxënësve të disa komuniteteve

Zyrtarët e ZKKK-së, me përkrahjen e Komitetit dhe drejtorit të Administratës, bënë ndarjen e mjeteve higjienike dhe mjeteve mësimore për nxënësit e komunitetit ashkali dhe rom në 9 shkolla fillore dhe në disa të mesme të komunës së Prishtinës të financuara nga Komuna. Me iniciativën e ZKKK-së dhe përkrahjen e Komitetit, familjet skamnore të komuniteteve RAE, serb e boshnjak, janë furnizuar me nga 2 m³ dru për ngrohje dhe kanë marrë nga 100 € ndihma emergjente nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Edhe për sezonin e ardhshëm Zyrtarët e ZKKK-së, me përkrahjen e Komitetit dhe drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mërqinjës Sociale, po përgatiten për furnizimin e familjeve skamnore të komuniteteve me dru për ngrohje.

Zyrtarët e ZKKK-së, me përkrahjen e Komitetit dhe drejtorit të Administratës, janë në përgatitje për ndarjen e dhuratave për fëmijët e komuniteteve ashkali dhe rom për festën e Vitit të Ri, të financuar nga Komuna. Zyrtarët e ZKKK-së, me përkrahjen e drejtorit të Administratës, mundësuan vazhdimin e mësimit fëmijëve të familjeve të komuniteteve të kthyer dhe të riatdhesuara, t'i vijojnë mësimet në shkollat përkatëse. Janë përkrahur dhe financuar festat e komuniteteve RAE: Dita e Flamurit Ashkali, Dita Ndërkombëtare e Romëve dhe Dita e Egjiptianëve të Kosovës.

Drejtoria e Administratës për çdo vit shpall muajin falas në regjistrimin civil për qytetarët e komunitetit RAE.

VIII. Projektet për zhvillim të komuniteteve jo shumicë në komunën e Prishtinës

Gjatë vitit 2015, Komiteti për Komunitete i ka përkrahur projektet për zhvillim të komuniteteve: 7 projekte dërguar Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe 2 projekte Drejtorisë së Infrastrukturës:

1. Projekti për vazhdimin e rjetit të ndriçimit të rrugës në Bërnice të Poshtme nga magjistralla Prishtinë-Podujevë, pikërisht prej urës deri në fshat, dhe ndriçimi i rrugëve dytësore të fshatit Bërnice të Poshtme;
2. Projekti për pastrimin dhe rrethimin e varrezave shumetnike në fshatin Kolevicë, faza II. Ky projekt u realizua.
3. Projekti për pastrimin dhe rrethimin e varrezave dhe oborrit të kishës, pjesa e sipërme 120 m, faza II, në Bërnice të Epërme;
4. Projekti për pastrimin dhe rrethimin e varrezave serbe në Bardhosh, ish-Nëntë Jugoviq;
5. Projekti për pastrimin dhe rrethimin e varrezave të komunitetit ashkali në fshatin Bërnice të Epërme;
6. Projekti për pastrimin dhe rrethimin e varrezave të komunitetit ashkali në fshatin Besi.
7. Projekti për pastrimin dhe rrethimin e varrezave të komunitetit serb në fshatin Hajvali.

8. Projekti për furnizim me ujë të pijshëm për Lagjen e poshtme të fshatit Slivovë. Të gjitha këto projekte janë kompletuar dhe janë dërguar në Prokurim, është shpallur tenderi, këto projekte janë në rrugë të mirë të realizimit.

Komiteti për Komunitete në takimin e datës 24.11.2015, është njoftuar edhe me disa projekte për vitin 2016.

1. Projekti për pastrimin dhe rrethimin e varrezave të komunitetit mysliman në Bardhosh;
2. Shtrimi i trotuarit në rrugën kryesore që kalon nëpër fshatin Bërnice e Poshtme;
3. Shtrimi me zhavorr i disa rrugëve dytësore në Bërnice të Poshtme;
4. Ndrëçimi i rrugës në Bërnice të Epërme prej mullirit deri në Lagjen e Milevcit.
5. Projekti për vendosjen e zebrave penguese dhe vërja e shportave të mbeturinave në rrugët "Caraleva" dhe "Bedri Gjini" në lagjen "Kodrën e Trimave" dhe disa projekte të tjera, për të cilat do të njoftohet Komiteti në takimin e radhës.

Drejtoria e Infrastrukturës:

1. Projekti për vazhdimin e asfaltimit të rrugës së fshatit Slivovë;
2. Projekti për meremetimin e një rruge dytësore, shtruarja me zhavorr në Lagjen e Gaiqve, në fshatin Lebanë.

IX. Sfidat

Gjatë vitit 2015, Komiteti për Komunitete ka hasur edhe në sfida dhe vështirësi për kryerjen e punëve. Sfidat kryesore:

Gjatë vitit 2015, Komiteti ka nxjerrë 55 konkluzione, disa prej të cilave nuk janë zbatuar nga ana e drejtorive kompetente.

Neglizhenca e disa drejtorive, institucioneve komunale dhe zyrtarëve të lartë komunalë, nuk ka mundësuar zbatimin e disa konkluzioneve të Komitetit për Komunitete:

1. Drejtoria e Financave dhe Pronës nuk e ka zbatua konkluzionin e Komitetit dhe as nuk e ka iniciuar te organet kompetente - Inspeksioni, lidhur me identifikimin, uzurpimin dhe lirimimin e banesës në ndërtesën banesore në "YU Pogram" në lagjen "Ulpiana", si dhe në objektin banesor në rrugën "Ragip Loxha" afër Shtëpisë së Pleqve.

2. Drejtoria e Urbanizmit nuk i ka zbatua dy konkluzione të Komitetit për emërimin e një komisioni profesional, i përberë nga inxhinierë të ndërtimit, i cili ka pasur për detyrë t'i vizitojë shtëpitë e familjeve serbe dhe të konstatojë se a mund të riparohen, apo duhet të ndërtohen.

3. Komiteti për Komunitete nuk është informua nga Zyra ligjore dhe Zyra e personelit lidhur me rregulloret, vendimet, konkurset e shpallura dhe aktet e tjera juridike.

4. Drejtoria e Kulturës nuk e ka zbatuar konkluzionin e Komitetit për informimin e ZKKK-së me të gjitha projektet e komuniteteve të dërguara në këtë drejtori gjatë vitit 2015.

Mund të konstatohet se Komiteti për Komunitete i ka shqyrtuar dhe realizuar të gjitha aktivitetet që janë planifikuar sipas Planit të punës 2015 dhe Rregullores së punës të Komitetit për Komunitete.

